

NË ËMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtarja Afërdita Bytyçi, më pjesëmarrjën e sekretares juridike Fahrije Beha, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. L. nga M., për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.94/2016, datë 01.06.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike më datë 10.10.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të akuzuarit, mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Sh. L.**, i biri i S. dhe S. e gjinisë F., i lindur më *data e lindjes...*, në M., tani me vendbanim në P., më dok.id.-letërnjoftim RKS, më nr.personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i Kompanisë Ndërtimore “L. C. SHPK”, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Nga data e papërcaktuar e deri më 10.02.2016, rreth orës 08:30, në oborrin e QKUK-së në Prishtinë, i akuzuari pa autorizim ka poseduar armë në atë mënyrë që pasi kishte një mosmarrëveshje verbale më një punëtor aty, dhe kur punëtoret e sigurimit të rampa e kanë ndaluar veturën e të akuzuarit të njëjtit e kanë marrë të akuzuarin në zyrën e tyre, dhe pasi ka ardhur policia gjatë kontrollimit në çantën e tij i është gjetur dhe sekuestruar një revole e tipit “Parabell e cal. 9 mm – Girisian, ngjyrë hiri në të zezë”, më numër serik T-6368-11, B02620, më karikator më 15 fishek të së njëjtës revole të cal.9 mm, të cilën e mbante pa autorizim,-

-më këtë ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73 të KPRK-së, dhe nenit 360, 361 dhe 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

Më dënim më gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilin dënim është i obliguar që t'a paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi më gjobë nuk mund të realizohet në mënyrat dhe format e parapara më nenin 46 të KPRK-së, gjykata këtë dënim do t'a shndërrojë në dënim më burg duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 € të dënimit më gjobë.

DËNIM PLOTËSUES

Të akuzuarit konform nenit 69 të KPRK-së, i konfiskohet revolja e tipit "Parabell e cal. 9 mm – Girisian", ngjyrë hiri në të zezë, më numër serik T-6368-11, B02620 më karikator më 15 fishek të së njëjtës revole të cal.9mm.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhën sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, më aktakuzën, PP/I.nr.94/2016, datë 01.06.2016, ka akuzuar Sh. L., për shkak të veprës penale, Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Lidhur më këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.10.2016, ku prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, lexoi aktakuzën dhe menjëherë pas leximit të aktakuzës, i akuzuari Sh. L. ka pranuar fajësinë duke deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale të kryer, dhe ka shtuar se është i penduar për veprën e kryer. I ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë t'a aprovojë dhe t'a këtë parasysh si rethanë lehtësuese më rastin e matjes se dënimit.

Pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, të cilin pranim fajësie e ka bërë pas konsultimeve më mbrojtësin e tij, duke qen i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, më të cilin pranim fajësie është pajtuar edhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 i KPPRK-së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit

të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuar, prandaj gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK-së.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjykata gjeti se pranimi i fajësisë është i plotë dhe bindës dhe se është në pajtim me provat e bashkangjitura në shkresa të lëndës, gjeti se në veprimet e të akuzuarit, manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, për çka edhe e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes se dënimit për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese mori se është hera parë që ka ra ndesh me ligjin dhe është penduar thellë për veprën e kryer, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, kurse rrethana rënduese nuk gjeti, andaj, i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim është adekuat më shkallën e rrezikshmërisë se veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se më këtë dënim do të arrihet të parandalohet kryesi nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj në përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale që është edhe qëllim i dënimit.

Vendimi mbi konfiskimin e armës u mor konform nenit 69 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marr në kuptim të nenit 450 par.2 nënpar. 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.388/16, datë 10.10.2016

**Sekretarja juridike,
Fahrije Beha**

**Gjyqtarja,
Afërdita Bytyçi**

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej
15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,
përmes kësaj gjykate.